



Keshilli i Bashkisë Korçë

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit: “Miratimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë”

Propozuesi: Projekt-akti është propozuar nga Kryetari i Bashkisë Korçë, në bashkëpunim me Sektorin e Emergjencave Civile të Bashkisë Korçë.

Sqarime për projekt-aktin: Plani Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë është një dokument strategjik dhe operacional, i hartuar mbi bazën e Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, Vlerësimit Vendor të Riskut dhe Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësit. Ai synon të përmirësojë parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen ndaj fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu në territorin e Bashkisë Korçë, duke mbrojtur jetën e njerëzve, pronën, trashëgiminë kulturore, infrastrukturën dhe mjedisin. Plani përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të bashkisë, institucioneve vendore dhe qendrore, si dhe bashkëpunimin me komunitetin, OJF-të dhe sektorin privat gjatë të gjitha fazave të menaxhimit të emergjencave civile.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik për projekt-aktin “Miratimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë” organizohet në zbatim të Kalenderit të Konsultimit Publik të Këshillit të Bashkisë dhe zhvillohet me anë të një takimi publik me palët e interesuara **ditën e enjte, më datë 16 prill 2026, ora 18:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Korçë.**

Pjesëmarrës:

Nga ana e Bashkisë: Anëtarë të Këshillit të Bashkisë; Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik; përfaqësues të Sektorit të Emergjencave Civile; përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike; përfaqësues të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Kontrollit të Territorit; përfaqësues të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe punonjës të tjerë të administratës bashkiake sipas fushës që lidhet me planin.

Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Korçë; kryetarët e njësive administrative dhe kryepleqtë e fshatrave; përfaqësues të OJF-ve që veprojnë në fushën e mbrojtjes civile, emergjencave dhe mjedisit; përfaqësues të biznesit lokal, sidomos sektorëve që preken nga emergjencat (turizëm, bujqësi, transport, shërbime); ekspertë të fushës së mbrojtjes civile, mjedisit dhe planifikimit urban; përfaqësues të institucioneve publike që operojnë në territorin e Bashkisë (shëndetësi, arsim, ujësjellës-kanalizime, energji).

Format e konsultimit: Konsultimi do të zhvillohet në formën e një takimi fizik publik me prezantim të Planit Vendor për Emergjencat Civile dhe diskutim të hapur, ku parashikohen komente, pyetje dhe përgjigje nga pjesëmarrësit. Për personat që nuk mund të jenë të pranishëm fizikisht, do të mundësohet dërgimi i komenteve dhe rekomandimeve me e-mail deri në afatin e përcaktuar.

Qëllimi i këshillimit publik	Këshillimi publik synon të tërheqë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit në lidhje me projekt-aktin “Miratimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë”, i cili prek të gjithë komunitetin, institucionet dhe subjektet private që veprojnë në territorin e bashkisë. Këshilli i Bashkisë Korçë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për pritshmëritë,
------------------------------	---



Këshilli i Bashkisë Korçë

	shqetësimet dhe propozimet e publikut në lidhje me masat e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, në mënyrë që vendimmarrja për miratimin e planit të bazohet në interesin publik dhe nevojat reale të komunitetit.
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Territori i Bashkisë Korçë përballlet me një gamë të gjerë rreziqesh natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, si tërmetet, përmbytjet, bllokimi i rrugëve nga dëborat dhe rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje, rreziqet biologjike dhe ato teknologjike. Përvoja e viteve të fundit, përfshirë tërmetet e vitit 2019 dhe situatat e motit ekstrem, ka treguar nevojën për një plan të përditësuar vendor që të orientojë të gjitha strukturat e bashkisë dhe institucionet e tjera në parandalimin, menaxhimin dhe rimëkëmbjen nga emergjencat civile. Plani Vendor për Emergjencat Civile i jep bashkisë një kuadër të qartë ligjor, institucional dhe operacional për të ulur riskun, për të mbrojtur jetën dhe pronën dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore për qytetarët në rast fatkeqësish.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë Korçë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit, ndër të tjera, mbi këto çështje orientuese: • Sa të informuar ndiheni për rreziqet kryesore që prekin Bashkinë Korçë (tërmete, përmbytje, dëborë, rrëshqitje dheu, zjarre në pyje, rreziqe biologjike, rreziqe teknologjike)? • A mendoni se masat e parandalimit dhe gatishmërisë të parashikuara në Planin Vendor për Emergjencat Civile janë të mjaftueshme për zonën ku banoni apo punoni? Nëse jo, cilat masa do të duhej të shtoheshin? • Cilat kategori të popullsisë në Bashkinë Korçë i konsideroni më të cenueshme në rast fatkeqësish (të moshuar, fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, familje me të ardhura të ulëta, komunitete të izoluar, etj.) dhe çfarë masash shtesë propozoni për mbrojtjen e tyre? • A konsideroni se strukturat e bashkisë dhe institucionet e tjera vendore (shëndetësi, arsim, ujësjellës-kanalizime, energji, etj.) janë të përgatitura për t'iu përgjigjur situatave të emergjencave civile? Ku shihni boshllëqe konkrete? • Sipas jush, cilat janë mënyrat më efektive për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve përpara dhe gjatë emergjencave (njoftime në faqen zyrtare, rrjetet sociale, media lokale, njoftime në lagje/fshatra, fletëpalosje, takime komunitare, etj.)?



Keshilli i Bashkisë Korçë

	• Çfarë roli prisni të ketë komuniteti, OJF-të dhe bizneset lokale në zbatimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile (p.sh. pjesëmarrje në stërvitje, vullnetarizëm, mbështetje logjistike, informim i publikut)? • A keni sugjerime konkrete për përmirësimin e koordinimit ndërmjet Bashkisë Korçë, institucioneve qendrore, OJF-ve dhe sektorit privat gjatë fazave të reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë? • A mendoni se plani duhet të përditësohet në intervale më të shpeshta në varësi të ndryshimeve të riskut dhe përvojës nga ngjarjet e fundit (p.sh. pas çdo fatkeqësie madhore apo çdo 2–3 vjet)?
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;	Takimi publik për konsultimin e projekt-aktit “Miratimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë” do të zhvillohet ditën e enjte, më datë 16 prill 2026, ora 18:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Korçë. Në këtë takim do të prezantohen qëllimet, struktura dhe masat kryesore të planit, pas së cilës do të zhvillohet diskutim i hapur me pjesëmarrësit, me qëllim mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij. Pjesëmarrja është e hapur për anëtarët e Këshillit, përfaqësues të administratës bashkiake, institucioneve vendore, OJF-ve, bizneseve dhe të gjithë të interesuarit nga komuniteti.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen drejtpërdrejt gjatë pjesëmarrjes në takimin publik. Në pamundësi për të marrë pjesë fizikisht, ato mund të dërgohen me e-mail në adresën: keshilibashkiakorce@gmail.com, deri në datën 16 prill 2026. Komente dhe mendime mund të lihen gjithashtu në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në faqen zyrtare të Këshillit të Bashkisë Korçë, pranë projekt-aktit “Miratimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Korçë”.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Gjatë konsultimit publik, Këshilli i Bashkisë do të shqyrtojë: • Shtimin e masave të parandalimit dhe gatishmërisë në zona specifike të Bashkisë Korçë (lagje urbane dhe fshatra me risk të lartë nga përmytjet, dëbora, rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje, etj.), duke përfshirë investime në infrastrukturë mbrojtëse, sisteme paralajmërimi të hershëm dhe sinjalistikë orientuese. • Forcimin e rolit të njësisë administrative, strukturave komunitare dhe vullnetarëve në menaxhimin e emergjencave civile, përmes



Keshilli i Bashkisë Korçë

	përcaktimit më të qartë të detyrave, trajnimeve periodike dhe organizimit të stërvitjeve praktike në terren. • Përmirësimin e mekanizmave të komunikimit dhe informimit me publikun, duke parashikuar përdorimin e një kombinimi mjetesh (faqja zyrtare e bashkisë, rrjetet sociale, media lokale, njoftime në qendra komunitare, etj.) për të siguruar që njoftimet për rreziqet dhe masat të arrijnë tek të gjithë qytetarët në kohë. • Rritjen e bashkëpunimit me bizneset lokale dhe OJF-të për sigurimin e burimeve shtesë (p.sh. mjete transporti, pajisje, ambiente pritjeje, mbështetje logjistike) gjatë fazës së reagimit dhe rimëkëmbjes. • Vendosjen e prioriteteve të qarta për mbrojtjen e infrastrukturës kritike (ujësjellës-kanalizime, rrjetet e energjisë, rrugë kryesore, objekte arsimore dhe shëndetësore) dhe mundësinë e përcaktimit të skenarëve alternativë të ndërhyrjes për secilin lloj rreziku. • Përshtatjen e planit me nevojat e veçanta të grupeve të cënueshme (të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, fëmijë, familje në nevojë), përmes parashikimit të masave specifike për evakuimin, strehimin dhe mbështetjen sociale të tyre në situata emergjente. • Rishikimin periodik të Planit Vendor për Emergjencat Civile, në përputhje me ndryshimet ligjore, dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe përvojën e fituar nga menaxhimi i fatkeqësive në territorin e Bashkisë Korçë.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Planin Vendor për Emergjencat Civile dhe relacionin shoqërues, mund t'i gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë dhe të Këshillit të Bashkisë Korçë, në seksionin "Konsultime Publike", në linkun e dedikuar për këtë projekt-akt. https://bashkiakorçe.gov.al/category/keshilli-bashkiak-2/lajmet-media/njoftimet/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas përfundimit të konsultimit publik, Sekretariati i Këshillit të Bashkisë do të përgatisë një përmbledhje të të gjitha rekomandimeve dhe komenteve të marra nga takimi publik, nga e-maili dhe nga Regjistri Elektronik i Konsultimit Publik. Kjo përmbledhje do t'u përcillet Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Mbrojtjes Civile të Këshillit dhe komisioneve të tjera përgjegjëse, të cilat do të shqyrtojnë një nga një rekomandimet dhe do të vendosin se cilat prej tyre do të merren parasysh në versionin përfundimtar të planit. Më pas do të hartohet projekt-vendimi i përmirësuar, i cili do të diskutohet dhe miratohet në seancë të hapur të Këshillit të Bashkisë; personat që kanë dërguar rekomandime do të



Keshilli i Bashkisë Korçë

	informohen për marrjen ose jo në konsideratë të komenteve të tyre dhe akti i miratuar do të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit.
Data e publikimit	17.03.2026